# NUK JE VETËM

## Doracak për prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta

Msc. Boletin Zenuni

Një udhërrëfyes shprese dhe praktike

BOLETIN ZENUNI

# NUK JE VETËM!

## DORACAK PËR PRINDËRIT E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Msc.BOLETIN ZENUNI

# NUK JE VETËM!

(Doracak për prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta)

SHTEPIA BOTUESE
Fabula
SHKUP, 2026

Autor: **Boletin Zenuni**
Titulli: **NUK JE VETËM! (Doracak për prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta)**

Redaktor profesional:
**Doc.dr Silvana Filipova**

Redaktor i përgjithshëm:
**Sevdail Demiri**

Recensent:
**Doc.dr Silvana Filipova**

Dizajni:
**Albert Zuka**

Botues
**Shtëpia Botuese FABULA**

ISBN: 978-9951-9254-2-6

Kontribuesit: Ky libër teknikisht u mundësua dhe u realizua me ndihmën e jashtëzakonshme të:

- Rajana Inzhiniering - Shkup
- Avicena Ks
- A.K
- Pité Bakery - Shkup

Copyright ©Autori
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për autorin

*Dedikuar luftëtarëve të vijës së parë të frontit*
*– prindërve që u bekuan me fëmijë të veçantë,*
*familjeve të tyre, me theks të veçantë dy*
*prindërve të mi që janë simbol dhe shembull*
*i një jete kushtuar Sarandës tonë, plagës dhe*
*njëherit dhuratës tonë të veçantë!*

# PËRMBAJTJA

HYRJE..... 11

**KAPITULLI I PARË**

Shprehjet "pengesa në zhvillim ose nevoja të veçanta" dhe "aftësi ndryshe"?..... 15

Llojet më të shpeshta të pengesave në zhvillim..... 17

Pse është i rëndësishëm identifikimi dhe intrevenimi i hershëm?.... 23

**KAPITULLI I DYTË**

Pranimi dhe emocionet e prindit..... 29

Reagimet fillestare..... 29

Lodhja emocionale dhe stresi..... 33

Procesi i pranimit..... 36

Si të përballen prindërit?..... 39

**KAPITULLI I TRETË**

Saranda – mes sfidave dhe privilegjeve e të qenurit " e veçantë "..... 45

Roli i familjes..... 49

Komunikimi në familje..... 53

Ndërtimi i një ambienti mbështetës..... 56

**KAPITULLI I KATËRT**

Bashkëpunimi me profesionistët ..... 63
Si të zgjidhni profesionistin e duhur? ..... 66

**KAPITULLI I PESTË**

Strategji praktike për përditshmëri ..... 73
Menaxhimi i sjelljeve sfiduese ..... 76

**KAPITULLI I GJASHTË**

Shoqëria dhe stigmat ..... 81
Shpresa dhe progresi ..... 84
Mini – udhëzues i shpejtë për prindër ..... 87

Recension i doracakut ..... 91
Biografia e Autorit ..... 93

Çdo herë kur flasim për personat me nevoja të veçanta apo me aftësi ndryshe, në veçanti për fëmijët, fokusi jonë bie mbi po këta protagonistë, sepse udhëhiqemi nga ndjenjat dhe emocionet njerëzore që zgjohen kur i takojmë, kur punojmë apo edhe kur jetojmë me ta.

Asnjëherë nuk do ta kuptoni rëndësinë dhe peshën e kësaj kategorie pa përjetuar në lëkurën tuaj atë rrugë dhe ato sfida që familjet e tyre i përjetojnë. Në mënyrë të pavullnetshme dhe të pavetëdijshme shpesh i harrojmë ata që në fund të çdo dite, mbi supet e tyre bartin faturat e jetës dhe sfidave me këtë kategori – prindërit e këtyre personave.

Unë si autor, kam pasur rastin dhe fatin, që në mua të gërshetohen dhe të kryqëzojnë rrugët dy fate jete, të jem vëlla i Sarandës së veçantë (më vonë do të flasim dhe për atë që e bën Sarandën të veçantë) si dhe të jem ekspert i fushës së trajtimit të këtyre personave ku po e jap angazhimin dhe përkushtimin tim profesional për të ju ndihmuar shumë Sarandave dhe shumë familjeve që jeta i ka bekuar me fëmijë të tillë. Pra, para se t'ju flas dhe t'ju drejtohem si profesionist fushe, në këtë doracak parasëgjithash, do t'ju

drejtohem si njëri prej jush, si familjar dhe luftëtar i vijës së dytë të frontit, pas prindërve të mi. Dhe mbi të gjitha, kjo që shkruhet këtu, është e përjetuar nga vetë unë si autor, vjen nga përvoja ime familjare, vjen nga sfidat dhe rruga që kam kaluar së bashku me familjen time, në qëllimin e vetëm – mbështetjen dhe kujdesin për motrën/bijën Sarandën.

Jam i vetëdijshëm që ky kontribut i imi modest, respektivisht ky doracak, është vetëm një pikë uji në oqean, krahas nevojave tuaja, por me anë të këtij angazhimi, dua t'ju them se JU NUK JENI VETËM.

Derisa ju të dashur prindër po e lexoni këtë paragraf, unë tashmë jam ngritur në këmbë në shenjë respekti dhe mbeshtetjeje për ju, për rrugëtimin tuaj dhe për fëmijët tuaj!

*Me shumë respekt e dashuri,*
*nga autori*

# HYRJE

Të jesh prind është një nga udhëtimet më të bukura, por edhe më sfiduese në jetë. Është një rrugë e mbushur me dashuri, sakrificë, shpresë dhe përkushtim. Kur ky rrugëtim përfshin rritjen e një fëmije me nevoja të veçanta, sfidat mund të duken edhe më të mëdha, por po aq e madhe është edhe forca që lind brenda prindit.

Ky libër në formë të doracakut është shkruar për ju – prindër që çdo ditë përballeni me të panjohura, me pyetje pa përgjigje të menjëhershme, me lodhje fizike dhe emocionale, por edhe me momente të vogla e të këndshme që kanë një vlerë të jashtëzakonshme. Është për ju që ndonjëherë ndiheni të vetëm, të pasigurt, apo të mbingarkuar, por që vazhdoni të ecni përpara për hir të fëmijës suaj.

Qëllimi i këtij doracaku nuk është të japë përgjigje perfekte për çdo situatë, sepse çdo fëmijë është unik, është botë më vete dhe çdo familje ka rrugëtimin e vet. Qëllimi është t'ju ofrojë udhëzim, mbështetje dhe ide praktike që mund ta bëjnë përditshmërinë tuaj pak më të lehtë dhe më të kuptueshme.

Në këto faqe do të gjeni informata të rëndësishme, këshilla konkrete dhe perspektiva që ju ndihmojnë të kuptoni më mirë fëmijën tuaj, të ndërtoni një lidhje më të fortë me të dhe të gjeni mënyra për ta përballuar më mirë çdo sfidë që mund të vijë.

Mbi të gjitha, ky libër është një kujtesë e vazhdueshme se nuk jeni vetëm. Ka shumë prindër që ecin në të njëjtën rrugë si ju, me të njëjtat shqetësime, por edhe me të njëjtën dashuri të pakushtëzuar.

Fëmija juaj nuk ka nevojë për një prind perfekt. Ai ka nevojë për ju – ashtu siç jeni: të fortë, të lodhur, të durueshëm, ndonjëherë të pasigurt, por gjithmonë të mbushur me dashuri.

Dhe kjo është më se e mjaftueshme.

# KAPITULLI I PARË

## SHPREHJET "PENGESA NË ZHVILLIM OSE NEVOJA TË VEÇANTA" DHE "AFTËSI NDRYSHE"?

Shprehjet ***"pengesa në zhvillim ose nevoja të veçanta"*** dhe ***"aftësi ndryshe"*** përdoren për të përshkruar individët që kanë sfida specifike - fizike, kognitive, emocionale ose shqisore - të cilat kërkojnë mbështetje shtesë ose përshtatje për të funksionuar plotësisht në jetën e përditshme.

Megjithatë, ka një dallim të hollë në filozofinë e këtyre dy shprehjeve apo nocioneve:

### 1. Pengesa në zhvillim ose nevoja të veçanta:

Kjo paraqet një shprehje tradicionale që fokusohet te ***asistenca*** që i duhet një personi, dhe përfshin një gamë të gjerë kategorishë:

- ***Sfida fizike:*** Vështirësi në lëvizje ose koordinim;
- ***Sfida shqisore:*** Shqetësime me shikimin (verbëri) ose dëgjimin (shurdhim);
- ***Sfida kognitive/zhvillimore:*** Si autizmi, sindroma Down, apo vështirësitë në nxënie (disleksia, disgrafia, etj.);
- ***Shëndeti mental:*** Ankthi i rëndë, ADHD ose çrregullime të tjera që ndikojnë në ndërveprimin social.

### 2. Aftësi ndryshe

Kjo shprehje është më moderne dhe ***fuqizuese***. Ajo synon të largojë stigmën e "invaliditetit" apo "mungesës" së diçkaje te njeriu.

- ***Ndryshimi i perspektivës:*** Në vend që të shohim atë që personi *nuk mundet* të bëjë, fokusohemi te mënyra se si ai bën diçka në formë alternative.
- ***Gjithëpërfshirja:*** Sugjeron që shoqëria është ajo që duhet të përshtatet (p.sh. duke ndërtuar rampa apo përdorur gjuhën e shenjave) në mënyrë që këto "aftësi ndryshe" të shprehen lirisht.

***Pse po kalohet nga shprehja "Invalid" në "Aftësi Ndryshe"?***

| SHPREHJA E VJETËR | SHPREHJA MODERNE | ARSYEJA |
|---|---|---|
| I paaftë / Invalid | Person me aftësi ndryshe | Njeh dinjitetin e njeriut para diagnozës. |
| Hendikep | Nevoja specifike | Fokusohet te zgjidhja (mbështetja) dhe jo te kufizimi. |

# LLOJET MË TË SHPESHTA TË PENGESAVE NË ZHVILLIM

Pengesat në zhvillim mund të shfaqen në forma të ndryshme. Disa nga më të zakonshmet përfshijnë:

❖ **Çrregullimet e spektrit të autizmit (ASD)**

Çrregullimi i Spektrit të Autizmit (ASD) është një gjendje komplekse neuro-zhvillimore që ndikon në mënyrën se si një person ndërvepron, komunikon dhe sillet. Përdorimi i fjalës ***"spektër"*** është kyç: ai tregon se autizmi manifestohet në mënyra shumë të ndryshme te çdo individ. Ja një vështrim i detajuar mbi shtyllat kryesore të këtij çrregullimi:

**1. Sfidat në komunikim dhe ndërveprim social**

Kjo është "zemra" e autizmit. Njerëzit në spektër mund të kenë vështirësi me:

- ***Komunikimin joverbal:*** Vështirësi në mbajtjen e kontaktit me sy, leximin e gjuhës së trupit ose përdorimin e gjesteve.
- ***Reciprocitetin social:*** Mund ta kenë të vështirë të nisin një bisedë ose të kuptojnë radhën e të folurit.
- ***Kuptimin e metaforave:*** Shpesh i marrin fjalët shumë tekstualisht (p.sh. nëse i thoni "më jep një dorë", mund të mos e kuptojnë që ju po u kërkoni ndihmë).

**2. Modelet e sjelljes dhe interesat e kufizuara**

Individët me autizëm shpesh gjejnë ngushëllim te rutina dhe parashikueshmëria:

- ***Sjelljet repetitive - përsëritëse:*** Lëvizje të përsëritura si rrotullimi i duarve (*flapping*), rrotullimi i objekteve ose përsëritja e frazave (ekolalia).
- ***Nevojë për rutinë:*** Ndryshimet e vogla në orar mund të shkaktojnë stres të madh.
- ***Interesa "fikse":*** Një pasion i jashtëzakonshëm dhe i detajuar për tema specifike (p.sh. trenat, astronomia, dinozaurët ose kodimi).

**3. Ndjeshmëria shqisore (senzorike)**

Shumë njerëz me autizëm përjetojnë botën me një intensitet ndryshe:

- ***Hiper-ndjeshmëria:*** Zhurmat e zakonshme (si fshesa me korrent) mund të jenë të dhimbshme; dritat e forta ose tekstura e disa rrobave mund të jenë të padurueshme.
- ***Hipo-ndjeshmëria:*** Mund të kenë një prag të lartë dhimbjeje ose kërkojnë stimulim të fortë (si të rrotullohen ose të kërcejnë) për të ndjerë trupin e tyre.

**4. Nivelet e mbështetjes**

Autizmi nuk klasifikohet më si "i lehtë" apo "i rëndë", por sipas shkallës së mbështetjes që kërkon personi:

1. ***Niveli 1 (Kërkon mbështetje):*** Personi flet, por ka vështirësi në socializim dhe organizim. (Më parë

njihej shpesh si Sindroma Asperger, sot në botë ka disa figura të njohura botërore që kanë lënë gjurmë në shumë sfera si psh: Elon Musk, Anthony Hopkins, Gretha Thunberg, Woody Allen, Susan Boyle etj).

2. ***Niveli 2 (Kërkon mbështetje të konsiderueshme):*** Sfidat në komunikimin verbal dhe joverbal janë të dukshme edhe me mbështetje në vend.
3. ***Niveli 3 (Kërkon mbështetje shumë të konsiderueshme):*** Vështirësi ekstreme në komunikim dhe sjellje që ndikojnë ndjeshëm në pavarësinë e përditshme.

### ❖ Çrregullimi i mungesës deficitit të vëmendjes dhe hiperaktivitetit (ADHD)

Çrregullimi i mungesës së deficitit të vëmendjes dhe hiperaktivitetit ***(ADHD)*** është një çrregullim neuro-zhvillimor që prek si fëmijët, ashtu edhe të rriturit. Ai karakterizohet nga një model i vazhdueshëm i mungesës së vëmendjes, impulsivitetit dhe në shumë raste, hiperaktivitetit që pengon funksionimin e përditshëm.

#### TRE TIPET KRYESORE TË ADHD-SË

Jo çdo person me ADHD është "hiperaktiv". Sipas simptomave mbizotëruese, ai ndahet në:

1. **Tipi me mbizotërim të mungesës së vëmendjes:**
   - Personi e ka të vështirë të përqendrohet, harron gjërat e përditshme dhe shpërqëndrohet lehtë.

- Shpesh duket sikur nuk dëgjon kur i flet ose bën gabime "nga pakujdesia".

2. **Tipi me mbizotërim të hiperaktivitetit dhe impulsivitetit:**
   - Nevoja e vazhdueshme për të lëvizur (dridhja e këmbëve, lëvizja e duarve).
   - Vështirësi për të pritur radhën ose ndërprerja e të tjerëve gjatë bisedës.

3. **Tipi i kombinuar:**
   - Ky është lloji më i shpeshtë, ku individi shfaq simptoma të të dyja kategorive të mësipërme.

## TRAJTIMI DHE MENAXHIMI

ADHD nuk "shërohet" si një sëmundje infektive, por menaxhohet me sukses përmes disa metodave:

1. ***Terapia e sjelljes (CBT):*** Ndihmon në krijimin e strukturave, rutinave dhe strategjive organizative (si përdorimi i listave, alarmeve etj.).
2. ***Mjekimi:*** Medikamentet (stimulues ose jo-stimuluese) ndihmojnë në balancimin e kimisë së trurit për të rritur përqendrimin.
3. ***Përshtatjet në mjedis:*** Në shkollë apo punë, dhënia e udhëzimeve të shkurtra dhe lejimi i pushimeve të shpeshta mund të rrisë produktivitetin.

**Vonesat tjera në zhvillim:**

- ***Sindroma Down***
- ***Sindroma Tourette***

**Vështirësitë në të nxënë – vështirësitë në të mësuarit**

Vështirësitë në të nxënë (ose çrregullimet specifike të të nxënit) janë sfida neurologjike që ndikojnë në aftësinë e trurit për të marrë, përpunuar, analizuar ose ruajtur informacionin. Është e rëndësishme të theksohet se këto vështirësi ***nuk kanë lidhje me inteligjencën***. Personat me këto sfida shpesh kanë inteligjencë mesatare ose mbi mesataren, por truri i tyre është "i lidhur" ndryshe.

## TRE LLOJET MË TË SHPESHTA

**1. Disleksia *(Vështirësitë në lexim)***

Ky është çrregullimi më i përhapur. Ai ndikon në aftësinë për të lidhur tingujt me shkronjat.

- ***Shenjat:*** Lexim i ngadaltë, ngatërrim i shkronjave që ngjajnë (si **b** dhe **d**), vështirësi në germëzim dhe në kuptimin e asaj që lexohet.

**2. Disgrafia *(Vështirësitë në shkrim)***

Lidhet me aftësitë motorike fine dhe procesimin e informacionit gjatë shkrimit.

- ***Shenjat:*** Shkrim i palexueshëm, vështirësi në mbajtjen e lapsit, mospërdorimi i duhur i hapësirave mes fjalëve dhe vështirësi në organizimin e mendimeve në letër.

**3. Diskalkulia *(Vështirësitë në matematikë)***

Ndikon në aftësinë për të kuptuar numrat dhe konceptet matematikore.

- ***Shenjat:*** Vështirësi në mësimin e tabelës së shumëzimit, vështirësi në leximin e orës analoge, ose probleme me llogaritjen e kusurit dhe koncepteve si "më shumë" apo "më pak".

**Aftësi të kufizuara fizike apo shqisore:**

- ***Aftësia e humbur e dëgjimit***
- ***Aftësia e humbur e shikimit***
- ***Paraliza cerebrale***
- ***Paraplegjitë***

# PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM IDENTIFIKIMI DHE INTERVENIMI I HERSHËM?

Identifikimi dhe intervenimi i hershëm (zakonisht para moshës 3 ose 5 vjeçare) konsiderohen "periudha e artë" për zhvillimin e një fëmije me pengesa në zhvillim. Arsyeja kryesore nuk është vetëm mjekësore, por mbi të gjitha biologjike dhe sociale. Kjo nuk do të thotë se gjithçka duhet të ndodhë menjëherë apo në mënyrë perfekte. Do të thotë të jesh i vëmendshëm, të kërkosh ndihmë kur është e nevojshme dhe të mos injorosh shenjat që mund të tregojnë se fëmija ka nevojë për mbështetje shtesë.

Ja pse çdo muaj në zhvillimin e fëmijës ka rëndësi:

### 1. Plasticiteti i trurit (Aftësia për të ndryshuar)

Truri i fëmijës në vitet e para të jetës është jashtëzakonisht "plastik". Kjo do të thotë se lidhjet nervore formohen me një shpejtësi marramendëse.

- ***Mësimi i lehtë:*** Në këtë moshë, truri mund të "ri-programohet" për të krijuar rrugë të reja komunikimi që kompensojnë sfidat gjenetike ose zhvillimore.
- ***Efektshmëria:*** Një terapi që zgjat 6 muaj te një 2-vjeçar mund të ketë rezultat më të madh se 2 vite terapi te një 10-vjeçar.

## 2. Parandalimi i efektit "Topi i borës"

Metafora e efektit ***"Topi i borës"*** (Snowball Effect) është një mënyrë e shkëlqyer për të kuptuar pse intervenimi i hershëm është kaq kritik. Imagjinoni një top të vogël bore që fillon të rrokulliset nga maja e një mali të lartë:

- ***Fillimi (Problemi i vogël):*** Në majë të malit, topi i borës është shumë i vogël—sa grushti. Ky përfaqëson një **vonesë të vogël fillestare**, për shembull: një fëmijë që në moshën 2-vjeçare nuk arrin të shqiptojë disa fjalë ose nuk reagon kur i thirret emri. Në këtë pikë, topi ndalohet shumë lehtë, mjafton ta prekësh me dorë.
- ***Rrokullisja (Grumbullimi i sfidave):*** Nëse nuk e ndalojmë topin në majë, ai vazhdon të rrokulliset. Duke u rrokullisur, ai mbledh më shumë borë dhe bëhet më i madh e më i rëndë.
    - Vonesa në të folur (borë e re) shndërrohet në ***vështirësi për t'u lidhur me moshatarët***.
    - Pamundësia për t'u lidhur me të tjerët shndërrohet në ***izolim social***.
    - Izolimi social shkakton ***rënie të vetëbesimit*** dhe ***frustrim/agresivitet***.
- ***Fundi i malit (Kompleksiteti):*** Kur topi arrin në fund të malit, ai tashmë është bërë një ortek gjigand. Në këtë pikë, nuk kemi të bëjmë më vetëm me një "vonesë në të folur", por me një lëshëm problemesh. Kur topi arrin në fund të malit, ai tashmë është bërë një ortek gjigand. Në këtë pikë, nuk kemi të bëjmë më vetëm me një "vonesë në të folur", por me një lëshëm problemesh:

- Vështirësi të rënda në shkollë.
- Ankth social.
- Probleme të sjelljes.
- Vështirësi në pavarësim.

Ndalimi i këtij "orteku" në moshën 15-vjeçare kërkon forcë, kohë dhe burime jashtëzakonisht të mëdha, dhe shpesh dëmet janë të vështira për t'u riparuar plotësisht.

### 3. Zhvillimi i pavarësisë

Sa më herët që një fëmijë mëson strategjitë për të menaxhuar sfidat e veta (p.sh. përdorimi i mjeteve ndihmëse për ADHD ose teknikat e komunikimit për Autizmin), aq më shumë gjasa ka që ai:

- *Të ndjekë shkollimin e rregullt,*
- *Të ketë nevojë për më pak mbështetje intensive në moshë madhore,*
- *Të integrohet plotësisht në tregun e punës.*

### 4. Mbështetja për familjen

Identifikimi i hershëm u jep prindërve:

- ***Kuptueshmëri:*** Ata ndalojnë së fajësuari veten ose fëmijën për sjelljet "e çuditshme".
- ***Mjete praktike:*** Mësojnë se si të komunikojnë dhe si ta strukturojnë mjedisin shtëpiak për të ndihmuar fëmijën.

# KAPITULLI I DYTË

## PRANIMI DHE EMOCIONET E PRINDIT

Roli i prindit në jetën e një fëmije me nevoja të veçanta është sa sfidues, aq edhe përcaktues për suksesin e fëmijës. Prindi nuk është thjesht një kujdestar, ai shndërrohet në avokatin, terapistin dhe mbështetjen kryesore emocionale të fëmijës. Momenti kur një prind kupton se fëmija i tij ka pengesa në zhvillim është shpesh një nga përvojat më të vështira emocionale. Është një moment që mund të sjellë shumë ndjenja të përziera - shok, frikë, pasiguri, madje edhe mohim. Këto reagime janë të natyrshme dhe njerëzore, prandaj mënyra e ballafaqimit me sfidat e reja është shumë e rëndësishme.

## REAGIMET FILLESTARE

Reagimet fillestare të prindërve kur përballen me faktin se fëmija i tyre ka nevoja të veçanta janë një proces kompleks psikologjik, i cili shpesh krahasohet me ***procesin e zisë***. Kjo ndodh sepse prindi "humbet" imazhin e fëmijës që kishte imagjinuar dhe duhet të pranojë një realitet të ri e të panjohur. Këto reagime janë krejtësisht njerëzore dhe nuk duhen gjykuar. Ja një zbërthim i gjerë i këtyre fazave:

### 1. Shok-u dhe mohimi (mbrojtja e parë)

Ky është reagimi i parë instinktiv. Truri ka nevojë për kohë që të procesojë informacionin e rëndë.

- ***Ndjenja e mpirjes:*** Prindërit shpesh thonë se ndihen sikur janë në një ëndërr ose sikur mjeku po flet për dikë tjetër.
- ***Kërkimi i "mrekullisë":*** Prindi fillon të vizitojë shumë mjekë me shpresën se dikush do të thotë që diagnoza është e gabuar.
- ***Pse ndodh?*** Mohimi shërben si një "jastëk" emocional që e mbron prindin nga shembja e menjëhershme shpirtërore derisa të mbledhë forcat dhe ta pranojë realitetin.

### 2. Zemërimi dhe frustrimi

Kur realiteti fillon të pranohet, dhimbja shpesh kthehet në zemërim.

- ***Drejtimi i zemërimit:*** Ai mund të drejtohet ndaj mjekëve ("Nuk e dalluan me kohë"), ndaj bashkëshortit/es ("Është faji i gjeneve tuaja"), ose edhe ndaj Zotit apo fatit ("Pse unë? Çfarë bëra që ta meritoj këtë?").
- ***Xhelozia sociale:*** Prindi mund të ndjejë zemërim kur sheh fëmijë të tjerë "neurotipikë" që arrijnë hapat e zhvillimit pa mundim.

### 3. Fajësia dhe negocimi

Kjo është një nga fazat më dëmtuese emocionalisht, ku prindi kthehet pas në kohë.

- ***Analiza e tepërt:*** "A ishte faji im që punova shumë gjatë shtatzënisë?", "A mos ndikoi ushqimi?", "Sikur ta kisha dërguar te mjeku një muaj më parë...".
- ***Negocimi:*** Prindi bën premtime të brendshme: "Nëse bëj këtë terapi 24 orë në ditë, fëmija do të shërohet plotësisht!". Kjo shpesh çon në sforcim të tejskajshëm.

### 4. Depresioni dhe çorientimi

Pasi zemërimi largohet, vjen një ndjenjë e thellë trishtimi dhe lodhjeje.

- ***Izolimi:*** Prindërit mund të largohen nga miqtë dhe familja sepse ndihen të keqkuptuar ose kanë frikë nga gjykimi i rrethit shoqëror apo familjar.
- ***Humbja e shpresës:*** Mund të ndihen të mbingarkuar nga pyetjet për të ardhmen: "Kush do të kujdeset për të kur unë të mos jem më?", "A do të flasë ndonjëherë?".

### 5. Drejt pranimit të realitetit dhe riorganizimit të jetës

Kjo nuk do të thotë se prindi "e harron" diagnozën, por mëson të jetojë me të.

- ***Përshtatja:*** Prindi fillon të kërkojë zgjidhje praktike (terapi, shkolla speciale, mjete ndihmëse).
- ***Zbulimi i vlerave:*** Shumë prindër në këtë fazë fillojnë të shohin anët e bukura të fëmijës që nuk

lidhen me diagnozën. Ata mësojnë të gëzohen për një buzëqeshje apo një kontakt sy më sy më shumë se sa për çdo sukses tjetër akademik.

Si të menaxhohen këto reagime?

1. ***Mos e shtypni dhimbjen:*** Është në rregull të qash, të jesh i zemëruar dhe të ndjehesh i pashpresë. Këto janë pjesë e procesit të shërimit.
2. ***Informohuni, por me limit:*** Mos u mbytni në internet me informacione të pakonfirmuara që vetëm sa shtojnë ankthin.
3. ***Kërkoni ndihmë profesionale:*** Jo vetëm për fëmijën, por edhe për veten (psikolog ose grupe prindërish).
4. ***Merrni gjërat "ditë pas dite":*** Mos u mundoni të zgjidhni problemet e 20 viteve të ardhshme që sot. Fokusohuni te ajo që mund të bëni këtë javë.

Pra, sa më i shpejtë të jetë tejkalimi i këtyre pengesave, respektivisht sa më i shpejtë të jetë pranimi i realitetit, aq më të mëdha janë gjasat që të krijohen rrugë dhe strategji adekuate për futjen e fëmijës në binarët e një trajtimi adekuat me qëllimin përfundimtar zbutjen e gjendjes së tij. ***Një mesazh për çdo prind:*** fëmija juaj ka nevojë për një prind "të mjaftueshëm", jo një prind "perfekt". Dashuria dhe pranimi juaj janë terapia më e fuqishme që ekziston.

# LODHJA EMOCIONALE DHE STRESI

Lodhja emocionale dhe stresi te prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta nuk është thjesht një "lodhje e zakonshme" pas një dite pune. Ajo njihet shpesh si ***"Burnout-i i prindërimit"*** dhe është një gjendje rrënuese që prek trupin, mendjen dhe shpirtin.

Kur kujdesi për një fëmijë kërkon vigjilencë 24/7, koordinim të pafund terapish dhe përballje me sfida sjelljeje, sistemi nervor i prindit qëndron në një gjendje të vazhdueshme "lufto ose ik".

### 1. Pse ky stres është unik dhe më i rëndë?

Ndryshe nga llojet e tjera të stresit, ky është ***kronik*** dhe ***i paparashikueshëm***:

- ***Vigjilenca e tejskajshme:*** Prindi duhet të parashikojë çdo krizë senzorike, çdo krizë epileptike ose çdo lëvizje të rrezikshme të fëmijës. Truri nuk "fiket" kurrë.
- ***Izolimi social:*** Shumë prindër pushojnë së daluri sepse kanë frikë nga gjykimi i të tjerëve ose sepse fëmija nuk e përballon dot ambientin e jashtëm.
- ***Barra financiare:*** Kostot e terapive, medikamenteve dhe dietave specifike shtojnë një shtresë ankthi të vazhdueshëm mbi mbijetesën ekonomike.

### 2. Shenjat e lodhjes emocionale *(Burnout)*

Është jetike që prindërit t'i njohin këto shenja para se të arrijnë në pikën e thyerjes:

- ***Mpirja emocionale:*** Ndjenja sikur "nuk ndjen më asgjë", as gëzim, as trishtim, thjesht funksionon si robot.
- ***Irritimi i shpejtë:*** Zemërim i papritur për gjëra të vogla me bashkëshortin ose fëmijët e tjerë.
- **Çrregullimet e gjumit:** Edhe kur fëmija fle, prindi nuk mundet, sepse mendja "garon" me shqetësime për të ardhmen.
- ***Somatizimi:*** Dhimbje koke të shpeshta, dhimbje shpine, probleme me tretjen ose rënie e imunitetit pa një shkak mjekësor të qartë.

### 3. Dinamika në çift dhe familje

Stresi i lartë mund të krijojë krisje në raportet familjare:

- ***Largimi i bashkëshortëve:*** Shpesh prindërit pushojnë së qeni "burrë e grua" dhe bëhen vetëm "kujdestarë". Bisedat e vetme janë për terapitë dhe progresin e fëmijës.
- ***Fëmijët e tjerë (vëllezërit/motrat):*** Ata mund të ndjehen të lënë pas dore, gjë që i shton prindit një ndjenjë tjetër faji.

### 4. Strategjitë për menaxhimin e stresit

Nuk mund ta zhdukni diagnozën, por mund të ndryshoni mënyrën se si e përballoni atë:

- ***Rregulli i "maskës së oksigjenit":*** Ashtu si në avion, duhet të vendosni maskën tuaj të parën që të mund të ndihmoni fëmijën. Një prind i shkatërruar nuk mund të jetë një terapist i mirë.
- ***Kërkimi i ndihmës:*** Pranoni ndihmën nga gjyshërit apo miqtë, qoftë edhe për një orë. Mos u mundoni të jeni "super-prindi".
- ***Ulja e pritshmërive:*** Jo çdo ditë duhet të jetë produktive. Është në rregull nëse shtëpia është rrëmujë ose nëse sot nuk u bë asnjë ushtrim terapie.
- ***Grupet e mbështetjes:*** Të flasësh me dikë që thotë «Edhe unë e kaloj këtë» është terapia më e mirë. Kjo largon ndjenjën e të qenit «i vetmi në botë».

***Një mendim i rëndësishëm:*** Vetëkujdesi nuk është luks, është ***përgjegjësi.*** Kur ju pushoni, ju po investoni direkt në mirëqenien e fëmijës tuaj.

### 5. Kur duhet kërkuar ndihmë profesionale?

Nëse vëreni se:

1. Mendimet negative janë të vazhdueshme dhe nuk largohen.
2. Keni dëshirë të largoheni fare nga situata.
3. Po përdorni alkool ose medikamente pa kontroll për t'u qetësuar.

# PROCESI I PRANIMIT

Procesi i pranimit nuk është një ngjarje e vetme, por një ***udhëtim emocional dhe psikologjik*** që mund të zgjasë me vite. Ai nuk do të thotë që prindi «e do» diagnozën apo që nuk ndjen më dhimbje, por do të thotë që ai pushon së luftuari me realitetin dhe fillon të punojë me të.

Ky proces shpesh përshkruhet si kalimi nga ***"fëmija i ëndërruar"*** tek ***"fëmija i vërtetë"***.

### 1. Dekonstruksioni i "fëmijës së ëndërruar"

Që nga momenti i konceptimit, prindërit krijojnë një imazh mental për fëmijën: si do të duket, çfarë sporti do të luajë, cilat shkolla do të ndjekë. Kur vjen diagnoza, ky imazh "vdes".

- ***Zia për pritshmëritë:*** Pranimi fillon me lejimin e vetes për të mbajtur zi për ato ëndrra që nuk do të realizohen (p.sh. fëmija që nuk do të flasë apo nuk do të jetojë kurrë plotësisht i pavarur).
- ***Lëshimi i kontrollit:*** Prindi kupton se nuk mund ta "ndreqë" fëmijën, sepse fëmija nuk është "i prishur" – ai thjesht ka një zhvillim ndryshe.

### 2. Kalimi nga "Pse?" te "Si?"

Kjo është pika e kthesës në procesin e pranimit:

- ***Faza e "Pse-së":*** Prindi është i bllokuar në të shkuarën, duke kërkuar shkaqe, fajtorë dhe kuptim metafizik. Kjo fazë harxhon shumë energji dhe sjell stagnim.

- ***Faza e "Si-së":*** Pranimi ndodh kur pyetja ndryshon: *"Si mund ta ndihmoj fëmijën tim sot?", "Si mund ta përshtas shtëpinë tonë?», «Si mund të komunikojmë më mirë?»* Këtu fillon veprimi dhe fuqizimi.

### 3. Rishikimi i sistemit të vlerave

Pranimi i vërtetë sjell një ndryshim rrënjësor në atë që prindi konsideron "sukses":

- ***Suksesi i rishpikur:*** Nëse më parë suksesi ishte nota 10 në shkollë, pas pranimit, suksesi bëhet fakti që fëmija arriti të mbajë lugën vetë ose bëri kontakt sy më sy për 3 sekonda.
- ***Gëzimi në thjeshtësi:*** Prindërit që arrijnë pranimin shpesh raportojnë se kanë fituar një perspektivë më të thellë për jetën, duke vlerësuar gjërat e vogla që të tjerët i marrin si të mirëqena.

### 4. Pengesat në rrugën e pranimit

Pranimi nuk është një vijë e drejtë, por ai ka ulje-ngritje (si një spirale):

- ***Ndjenja e tradhtisë:*** Ndonjëherë prindi ndihet sikur po e "tradhton" fëmijën nëse pranon se ai ka kufizime. Ata mendojnë se "të pranosh" do të thotë "të dorëzohesh". *Në fakt, pranimi është hapi i parë drejt ndihmës efektive.*
- ***Presioni social:*** Gjykimi i rrethit ose i familjes së gjerë që thonë "mos u dorëzo, ai do të bëhet normal", e vështirëson pranimin, sepse ushqen shpresën e rremë.

**5. Si duket pranimi në praktikë?**

Një prind që ka arritur fazën e pranimit:

1. ***Nuk fshihet:*** Flet hapur për diagnozën e fëmijës pa u ndjerë në faj apo turp.
2. ***Kërkon ndihmë:*** Nuk përpiqet të bëjë heroin, por bashkëpunon me profesionistët.
3. ***Dallon fëmijën nga diagnoza:*** Sheh personalitetin, pëlqimet dhe karakterin e fëmijës, jo vetëm "simptomat".
4. ***Planifikon të ardhmen:*** Merr hapa konkretë për të siguruar mirëqenien e fëmijës në plan afatgjatë.

***Një metaforë e famshme:*** Emily Perl Kingsley e krahason këtë proces me planifikimin e një udhëtimi në ***Itali***. Ju prisni të shihni Koloseumin dhe Venedikun, por avioni ulet në ***Holandë***. Holanda nuk është më e keqe se Italia, është thjesht ***ndryshe.*** Ka mullinj ere dhe tulipanë në vend të kishave të vjetra. Pranimi do të thotë të pushoni së qari për Italinë dhe të filloni të shijoni bukurinë e Holandës.

# SI TË PËRBALLEN PRINDËRIT?

Përballja me sfidat e prindërimit të një fëmije me nevoja të veçanta nuk është një sprint, por një ***maratonë e gjatë***. Nuk ka një ***"recetë magjike"***, por ekzistojnë disa shtylla strategjike që i ndihmojnë prindërit të mos thyhen rrugës dhe të ndërtojnë një jetë cilësore për veten dhe fëmijën.

Ja se si mund të menaxhohen këto sfida në mënyrë më të zgjeruar:

### 1. Ndërtimi i një "sistemi mbështetës" (Mos e bëni vetëm)

Izolimi është armiku më i madh. Prindërit që përpiqen t'i bëjnë të gjitha vetë "digjen" (burnout) shumë shpejt.

- ***Grupet e prindërve:*** Kërkoni komunitete (fizike ose online) që kalojnë të njëjtën gjë. Të dëgjosh se «edhe unë e kam kaluar këtë» largon ndjenjën e turpit dhe vetmisë.
- ***Delegimi i detyrave:*** Nëse dikush ju ofron ndihmë (një i afërm apo mik), mos thoni «jo faleminderit, ia dal vetë». Thoni: «Po, mund të qëndrosh me fëmijën një orë sa të bëj një dush ose të pi një kafe në qetësi?"
- ***Ndihma profesionale për ju:*** Konsultimi me një psikolog për veten tuaj nuk është luks, është mjet mbijetese për të procesuar traumën dhe stresin kronik.

### 2. Edukimi dhe fuqizimi (informacioni është fuqi)

Pasiguria ushqen frikën. Sa më shumë të dini për diagnozën e fëmijës, aq më pak "e frikshme" duket e ardhmja.

- ***Bëhuni ekspertë:*** Mësoni nocionet mjekësore, ligjet për arsimin special dhe të drejtat që ju takojnë. Kjo ju ndihmon të mos ndiheni të pashpresë përballë institucioneve.
- ***Filtra për informacionin:*** Shmangni "kurat magjike" në internet që premtojnë shërim të menjëhershëm. Fokusohuni te metodat e bazuara në shkencë për të kursyer energji dhe para.

### 3. Menaxhimi i "energjisë" në vend të "kohës"

Koha nuk mjafton kurrë, ndaj duhet të menaxhoni forcën tuaj emocionale.

- ***Zgjidhni betejat tuaja:*** Nuk mund të punoni për çdo gjë simulativisht. Nëse këtë muaj fokusi është te të folurit, mos u stresoni nëse fëmija nuk po mëson ende të hajë vetë me pirun.
- ***Rregulli i 15 minutave:*** Gjeni çdo ditë 15 minuta që janë ***vetëm për ju.*** Pa telefon, pa detyra, pa mendime për fëmijën. Kjo shërben si një "restart" për sistemin nervor.

### 4. Strategjitë për ruajtjen e martesës dhe familjes

Shpesh vëllezërit/motrat e tjerë ose raporti me partnerin mbeten në plan të dytë.

- ***Takime pa "temën e djalit ose vajzës":*** Caktoni kohë me partnerin ku ndalohet të flitet për terapitë apo progresin e fëmijës. Ju duhet të kujtoni pse u dashuruat si fillim.
- ***Koha cilësore me fëmijët e tjerë:*** Edhe 10 minuta lojë me fëmijën tjetër (pa praninë e fëmijës me nevoja të veçanta) mjaftojnë që ai të mos ndihet i padukshëm.

### 5. Fokusimi te "sot-i"

Ankthi vjen nga mendimet për të ardhmen ("Çfarë do të bëhet pas 20 vitesh?").

- ***Ulni pritshmëritë, rritni vlerësimin:*** Gëzohuni për hapat e vegjël. Nëse fëmija sot ka bërë diçka që dje nuk e bënte, festojeni!
- ***Pranimi i ditëve të këqija:*** Do të ketë ditë kur do të qani, do të bërtisni dhe do të doni të dorëzoheni. ***Kjo është normale.*** Mos i shtoni vetes edhe barrën e fajit mbi barrën e lodhjes.

### 6. Përshtatja e mjedisit *(Jo e fëmijës)*

Në vend që të mundoheni me forcë ta bëni fëmijën të përshtatet në një botë "normale", përshtatni botën tuaj për të.

- ***Shtëpia si laborator:*** Krijoni rrugë komunikimi (me foto, shenja), organizoni hapësirën që të jetë e parashikueshme. Një shtëpi e organizuar mirë redukton krizat e fëmijës dhe, si pasojë, stresin tuaj.

***Mbani mend:*** Ju jeni "motori" i zhvillimit të fëmijës tuaj. Nëse motori nxehet shumë dhe nuk merr vaj (pushim, mbështetje), ai do të ndalojë. Kujdesi për veten është akti më i madh i dashurisë që mund të bëni për fëmijën tuaj.

### Një mesazh për prindin

Është në rregull të ndihesh i lodhur. Është në rregull të ndihesh i pasigurt. Por është gjithashtu e rëndësishme të kujtosh se nuk je vetëm në këtë rrugëtim.

Forca e një prindi nuk qëndron në mungesën e emocioneve, por në aftësinë për të vazhduar përpara pavarësisht tyre.

# KAPITULLI I TRETË

# Saranda

## mes sfidave dhe privilegjeve e të qenurit "e veçantë"

Përshëndetje i nderuar lexues, unë jam Saranda Zenuni, 39 vjeçare, motra më e dashur e Boletinit, Shkodranes dhe Llaushës. Unë jam arsyeja që nuk i lejoj të plaken dy prindërit e mi - Enveri dhe Suzana, jam tezja heroinë e Janinës, Jonit dhe Vraninës. Më quajnë person i veçantë, kujdesen për mua në mënyrën më të mirë të mundshme. Kam diagnozë shumë të rrallë, e quajnë Cornelia De Lange Syndrome dhe prek shumë pak njerëz në botë.

Si fëmijë kam qenë vajzë e dashur dhe e urtë, në mënyrën time jam përkujdesur për punët e shtëpisë, e afërt me familjarët, por me ndryshime të shpeshta në disponim dhe në sjellje. Prindërit e mi qysh në fillim kanë vërejtur se

unë nuk jam si fëmijët e tjerë, edhe pse mosha ime rritej, vitet kalonin unë ende nuk i kisha tejkaluar vështirësitë në të folur, vështirësitë në sjellje. Fatkeqësisht, sa vija dhe izolohesha dhe më tepër në botën time fëmijërore. Edhe pse kisha filluar shkollën, familja ime e kishin të vështirë të kuptonin se çka ishte ajo që më pengonte të isha si fëmijët e tjerë. Në shkollë shkoja me motrën e madhe Shkodranën, ajo ishte kujdestarja ime gjatë gjithë kohës, më ndihmonte që unë të fitoja aftësi që t'i njihja shkronjat, të mësoja disi një vjershë, dhe të merrja një pesëshe që për mua ishte gëzimi më i madh. Në shkollë më kanë dashur të gjithë, nga mësimdhënësit e deri tek punëtorët e thjeshtë teknik, më kanë ndihmuar pa masë. Më vonë edhe pse i vogël në moshë, kujdesej edhe vëllau im Boletini, edhe pse ndoshta ndonjëherë e kam turpëruar pa dashje për sjelljet e mija dhe për ato momentet kur kam pasur kriza që atë kohë nuk e dinim se pse vinin. Sa rritesha, aq më tepër shtoheshin krizat dhe vështirësitë.

Më vonë lindi motra e vogël Llausha, nuk e pranova mirë, nuk e dija pse. Prindërit e mi mendonin se është normale, sepse fokusi ishte kthyer drejt saj, por situatat rëndoheshin. Më vonë filluan të shtoheshin krizat psikoemocionale me tendenca te agresivitetit ndaj tjerëve dhe posaçërisht ndaj vetës. Nuk ndjeja dhimbje në plagë, përkundrazi shtohej nevoja për më tepër stimuj të tillë.

Mbarova shkollën fillore, dhe me periudhën e pubertetit unë pothuajse ndryshova tërësisht sa i përket sjelljeve të mia. Familja ime i shteroi të gjitha mundësitë në vendim tim për të gjetur zgjidhje, saqë u detyrua që të më

zhvendosin në Zvicër për të gjetur ilaç për mua, e kjo nuk kaloi pa vështirësi dhe sfida. Atje u testova gjenetikisht në një nga institutet dhe laboratoret më të fuqishme në botë në sferën e gjenetikës, dhe raporti në fund tregoi se unë kisha sindromën Cornelia de Lange, një miks gjendjesh, duke filluar nga aftësia e kufizuar intelektuale (e ulët), autizmi, çrregullim të integritetit senzorik dhe jo vetëm, gjithë ato vite dhe ato sjellje morën formë me këtë diagnozë.

Fillova një jetë të re në institucione përkujdesëse, me kujdes maksimal për mua, por për prindërit e mi, në realitet filloi golgota më e madhe në jetën e tyre, të jetuarit në mërgim larg fëmijëve tjerë. Nëna dhe babai im edhe sot në moshë të shtyrë, pas 24 viteve, po vazhdojnë të jetojnë mes vendlindjes dhe mes meje, me zemër të thyer, të lodhur nga jeta, por me shumë motiv dhe me shumë shpresë, sepse ata jetojnë për buzëqeshjen time, dhe jetojnë për atë orë vizite një herë në javë. Unë shpesh hidhërohem kur ata nuk më vijnë në ditën e caktuar, me shpjegimet se janë të sëmurë, u është prishur vetura, kanë punë, e në fakt ata fshehurazi dhe me dozë faji ikin në vendlindje tek anëtarët tjerë të familjes sime, sepse edhe ata kanë nevojë, por ja që sëmundja ime nuk ma mundëson ta kuptoj.  Për pak sa nuk harrova dhe diçka për veten time...! Unë kam shumë aftësi që njerëzit e tjerë pa pengesa në zhvillim nuk i kanë! Për shembull, unë nuk e kuptoj dhe nuk e njoh konceptin e kohës, nuk e njoh orën, ditët, javët, muajt e vitet, por unë saktë e di dhe i përkujtoj kujdestarët e mi çdo herë kur është koha e barërave dhe terapisë së rregullt, me saktësi e di që është tani koha e terapisë! Pastaj, kam një memorie të jashtëzakonshme,

mbaj mend detaje dhe njerëz edhe pse i kam përjetuar njëherë ose i kam takuar vetëm njëherë, ndërsa posedoj dhe një anë shumë të fortë emocionale të padukshme dhe të pashpjegueshme, i parandiejë situatat. Kjo që e tregova këtu është vetëm një pjesë e vogël e historisë që e ka kaluar dhe e kalon familja ime me mua, e besoj se një pjesë e juaja që po e lexoni, jeni në të njëjtat këpucë si të prindërve të mi, por ndoshta jo me mundësitë e njëjta. Ata hoqën dorë nga kënaqësitë e jetës për t'u përkujdesur për mua, ata po vazhdojnë të luftojnë për mua, edhe pse tashmë jemi së bashku në perëndimin e kësaj historie sa të dhimbshme poaq krenare.

Më falni për lotët dhe emocionet, ju jeni të bekuar me ne, e ne jemi të bekuar me ju!

# ROLI I FAMILJES

Rritja e një fëmije me nevoja të veçanta nuk është një rrugëtim që i përket vetëm një prindi. Është një proces që përfshin të gjithë familjen. Mbështetja, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi brenda familjes luajnë një rol kyç në zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës. Roli i familjes nuk është thjesht mbështetës, ai është ***ekosistemi parësor*** ku fëmija me pengesa në zhvillim formon identitetin, sigurinë dhe potencialin e tij. Kur një familje ka një anëtar me nevoja të veçanta, e gjithë dinamika e saj ndryshon, duke u shndërruar në një njësi që funksionon si mjek, mësues dhe avokat.

Ja një vështrim i gjerë mbi rolet specifike dhe rëndësinë e secilit anëtar:

### 1. Familja si "agjenti kryesor i socializimit"

Për një fëmijë me pengesa në zhvillim, bota e jashtme mund të jetë konfuze ose armiqësore. Familja shërben si ura lidhëse:

- ***Përshtatja e komunikimit*:** Familja është e para që mëson "gjuhën" e fëmijës (qoftë përmes shenjave, gjesteve apo mjeteve vizuale) dhe i mëson atij se si të ndërveprojë me të tjerët.
- ***Ndërtimi i vetëbesimit*:** Dashuria e pakushtëzuar e familjes e mbron fëmijën nga stigmatizimi që mund të hasë jashtë shtëpisë. Një fëmijë që ndihet i vlerësuar në shtëpi, ka më shumë guxim të eksplorojë botën.

### 2. Roli i prindërve: bashkëpunëtorë të profesionistëve

Prindërit nuk janë thjesht vëzhgues të terapive, ata janë ***bashkë-terapistë***:

- ***Vazhdimësia e terapisë*:** Ajo që mësohet në seancat 45-minutëshe me logopedin ose terapistin duhet të zbatohet nga prindërit në shtëpi gjatë 23 orëve të tjera.
- ***Vëzhgimi klinik*:** Prindërit janë mbledhësit më të mirë të të dhënave. Ata vërejnë ndryshimet më të vogla, efektet anësore të medikamenteve ose progresin që mjekët mund ta humbasin në një vizitë të shkurtër.

### 3. Roli i vëllezërve dhe motrave

Vëllezërit dhe motrat luajnë një rol kritik dhe shpesh të anashkaluar:

- ***Modeli i sjelljes*:** Fëmija me pengesa në zhvillim shpesh imiton vëllain ose motrën më shumë se prindërit. Ata janë «terapistët e lojës» më natyralë.
- ***Sfida e "Fëmijëve të padukshëm"*:** Prindërit duhet të kenë kujdes që vëllezërit/motrat neurotipikë të mos ndjehen të lënë pas dore. Ata kanë nevojë për shpjegime të qarta mbi gjendjen e vëllait/motrës që të mos zhvillojnë ndjenja faji ose xhelozie.

### 4. Familja e gjërë (gjyshërit, dajallarët, tezet)

Mbështetja nga familja e gjerë përcakton nëse prindërit do të pësojnë *burnout* apo jo:

- ***Mbështetja emocionale:*** Gjyshërit mund të ofrojnë periudha pushimi për prindërit, duke u kujdesur për fëmijën që prindërit të kenë kohë për veten.
- ***Rreziku i gjykimit:*** Ndonjëherë familja e gjerë (nga mungesa e informacionit) mund të jetë burim stresi duke ofruar këshilla të padobishme apo duke mohuar diagnozën. Edukimi i tyre është i domosdoshëm.

### 5. Sfidat e funksionimit familjar

Për të luajtur rolin e saj me sukses, familja përballet me tri sfida madhore:

